

Denada Elezi ushtron detyrën e Këshilltarit Ligjor, pranë Njesisë së Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, prej muajit Janar 2020.

Në vitet 2006-2010 ka përfunduar studimet e larta 4-vjecare në Fakultetin Juridik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Në përfundim të studimeve pasuniversitare Master Profesional, është diplomuar në "Të drejtë Civile" në Universitetin "Justiniani I", gjatë periudhës Tetor 2010 - Shkurt 2012.

Ka përvojë pune si në sektorin privat, ashtu edhe në administratën publike. Konkretisht, gjatë vitit 2011 ka ndjekur intership pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Shqiptaro-Britanike, si dhe praktikë profesionale si asistent avokat në zyrë avokatie. Në vitin 2013 ka marrë titullin Avokat.

Prej muajit Prill 2013 e deri në Janar të vitit 2020, ka mbajtur detyrën e specialistes në Sektorin Juridik, në Drejtorinë Juridike të Monitorimit dhe Verifikimit të Procedurave pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, ku ndër të tjera ka patur si pjesë të punës edhe ndjekjen e proceseve gjyqësore. Ka njohuri të mira kompjuterike, si dhe të gjuhëve të huaja Italisht dhe Anglisht, kjo e fundit e mbrojtur me certifikatë të IELTS nga British Council, niveli B2 Academic. Ka marrë pjesë në trajnime për fusha të ndryshme legjislativë.